



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Jurist me Drejtë Biznesi”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar
“Qiriazi”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Arbër Gjeta

2. Prof. Asoc. Dr. Ilir Rusi

Tetor/2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përbledhës

Gjatë ketij vlerësimi të jashtëm ne si ekspertë jemi drejtuar nga gjykimi në rradhë të parë i përputhjes së programit të studimit me ligjshmërinë e tij. Në analizën e kryer kemi vëzhguar me kujdes punën e bërë nga grupi i vlerësimit të brendshëm i cili ka hartuar RVB por pa u kufizuar në të edhe gjithë dokumentacionin përkatës shoqërues dhe kemi treguar kujdesin e duhur gjatë vizitës në institucion ku kemi kërkuar të na vihen në dispozicion dokumenta shtese.

Në lidhje me vlerësimin për çdo fushë kemi ruajtur objektivitetin e duhur dhe ashtu edhe në përfundime dhe rekomandime. Gjatë vlerësimit u get se ndryshe nga sa paracaktohej shkalla e përbushjes në RVB për fushat e veçanta kishte mangësi dhe mospërpushje të disa standardeve. Kështu janë përbushur kryesisht standartet që kan lidhje me mësimdhënien, mësimnxënien, vlerësimin dhe kompetencat si dhe fusha e burimeve njerëzore që janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit.

Në fushat e tjera që kanë lidhje me aspekte të organizimit e drejtimit të programit të studimit, strukturës e përbajtjes së programit, raportit me studentët dhe sigurimit ë cilësisë së programit, përbushja e standardeve është e pjesëshme.

Nga gjetjet përfundimtare të këtij raporti do të veçonim se me riçeljen e këtij institucioni strukturat drejtuese kanë ndërmarrë një proces të mirë ringritje, ky institucion ofron një infrastrukturë cilësore për të zhvilluar proceset mësimore, investimet që janë kryer janë të shumta dhe është punuar me një strategji ambicioze për të ardhmen. Nga analiza e thellë si më lart dalin në pah edhe shumë mungesa dhe mangësi që me kalimin e kohës duhet të rregullohen, ku veçohet mungesa e stafit administrativ apo nevoja për përmirësimin e kuadrit tregullativ dhe një shpërndarje më efektive e detyrave sipas standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Ky proces i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Master Profesional “Jurist me Drejtë Biznesi” nis me marrjen e detyrës nga ana e Ascal dhe me leximin e kujdeshëm të gjithë dokumentacionit të depozituar në momentin e parë nga KUQ (RVB dhe dokumentat mbështetës).

Pasi hulumtuam dokumentacionin ishim gati të kryenim vizitën në institucion e cila u zhvillua në dy ditë. Ditën e parë ne si ekspertë së bashku me koordinatorin teknik të Ascal përcaktuam planin e punës. Si fillim zhvilluam takim me Dekanin e Njësisë Kryesore dhe Përgjegjësin e Njësisë Bazë. Në takimet e rradhës kryem bashkëbisedim me grupin e vlersimit të brendshëm, me stafin akademik, me studentët duke ngritur bashkëbisedimin mbi pyetjet që kishim përcaktuar në dokumentacionin e parë online dhe RVB e dorëzuar nga vetë institucioni.

Bazuar në dokumentacionin e DVV, Kolegji Universitar “Qiriazi”, është një institucion privat i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë. Kolegji Universitar “Qiriazi” (KUQ) me qendër në Tiranë, ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2006 - 2007, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.274, datë 10.05.2006, “Për dhënen e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”. Në zbatim të Ligjit të ri Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në vitin akademik 2016-2017 institucioni riorganizohet me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 92, datë 01.03.2017 nga Shkollë e Lartë Universitare Private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” në Kolegji Universitar “Qiriazi” dhe miratohet Statuti i ri. Ky program studimi është hapur me UMASH nr.589 datë 07.12.2011 me 90 ECTS dhe riorganizuar me pas me 60 ECTS.

Dita e dytë e takimeve ishte e fokusuar në takimin me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Komisionin e Kërkimit Shkencor, zyrat administrative (Zyra Marrëdhënieve me Jashtë, pranime, karriere, Zyrën e Burimeve Njerëzore, sekretarinë mësimore dhe vëzhgimin e mjediseve të KUQ).

Mbas kryerjes së vizitës në institucion dhe bisedave sqaruese dhe vëzhgimin on site kërkuan një sërë dokumentash të cilat ishin me rëndësi për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe na u vunë në dispozicion.

Përfundimi i procesit ishte me shkrinin e këtij reporti të vlerësimit të jashtëm duke patur të qartë gjendjen e paraqitur nga vetë institucioni në RVB, dokumentacionin përkatës dhe gjetjet faktike përgjatë vizitës.

Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako.

Më datë 15.10.2019 me anë të sistemit AMS dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Institucioni ka sjellë me anë të shkresës nr.262 prot date 18.10.2019 dhe me anë te sistemit AMS, datë 21.10.2019 komentet mbi draft reportin. GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft reportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

Për komentin: **"Ne fushen e I, standarti 1.3 kriteri 6, raporti shprehet se: "Praktika profesionale duhet te ishte me e gjate . ". Sqarojme se ne nje program studirni profesional, me 60 ECTS (nje vit akademik), nuk mund ti lihet me shurne kohe ne dispozicion praktikes, ne gykimin tone me shurne rendesi ka ngarkesa dhe rnenyra e zhvillimit te praktikes profesionale".** GVJ mendon se duke u nisur nga mënyra sesi zhvillohet praktiva dhe si shlyhen detyrimet në fund nga studenti (duke përfshirë dorëzim rapporti) ka vend për përmirësimë. Në lidhje me komentin jemi të mendimit, megjithëse e njohim problematikën e planit 60 ECTS për MP në përgjithësi praktika duhet të zejë një vend më të rëndësishëm. **Raporti në ketë pike nuk ndryshon.**

Për komentin: **"Ne fushen II, standarti 2.1, raporti shprehet se: "mungon plani strategik per fakultetin e Drejtësise". Sqarojme se ky dokument eshte kete e pohoni edhe ju ne vleresirnin qe beni me poshte ne standartin II.3, kriteri I".**

GVJ eshte shprehur "Në vlerësimin e GVJ do ishte e nevojshme të përpunohej një plan strategjik i lidhur me Fakultetin e Drejtësisë". Sqarojme se kemi shprehur rekomandimin se plani strategjik i lidhur me Fakultetin e Drejtësise te perpunohej dhe nuk kemi shprehur mungenë e tij.

Raporti në ketë pike do te ndryshoje duke hequr fjalën "nje"

Për komentin: **"Ne Draft-raport per disa standarte, si ai I.4 por edhe te tjere nuk evidentohen mangesi. ose evidentohen keto ne rrnyre te perseritur nga njeri kriter ne tjetrin dhe per rjedhoje ne perfundirn, behet vleresirni minimal i standartit dhe fushes perkatese me "pjeserisht"".** GVJ ka bërë një vlerësim kompleks duke u nisur nga metodologja e punës sic është përshkruar më sipër në fillim të rapportit. Është formati i rapportit që i kërkon këto vlerësimë në mënyrë të përsëritur dhe në gjykimin tonë kur i jemi përgjigjur pyetjes për kriterin në fjalë vlerësimi ka qenë pjesërisht. **Raporti në ketë pike nuk ndryshon.**

Për komentin: **"Ne gjykimin tone, kater fushat e para i perm bushin standartet vleresirnit "kryesisht"".** GVJ është shprehur me gjykimin e tij në lidhje me përbushjen e standartit. Duhet patur parasysh se standarti nuk është vetëm kriteret minimale të licencsimit të një programi apo institucioni por del nga praktikat e mira apo eksperiencia në fushën e arsimit përkatës që ekzistojnë në botën akademike në Shqipëri, BE e më gjerë. **Raporti në ketë pike nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Jurist me Drejtim Biznesi”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit MP “Jurist me Drejtim Biznesi” nga leximi i Statutit të KUQ, rregullores të programit të studimit dhe Planit Strategjik të zhvillimit të KUQ, rezulton se është në përputhje me interesat kombëtare.			
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Gjithashtu nga sa rezulton më lart dhe nga një vështrim i planit mësimor të ofruar në fushën e thellimit të studimeve brenda lëmit të së drejtës konsiston se programi i studimit ruan vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Programi i studimit MP “Jursit me Drejtim Biznesi” ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit ashtu sikur përcaktohet nga aktet e brendshme të tij siç janë Statuti dhe Plani strategjik 2017-2021. KUQ ka të përcaktuar në organigramën e tij Fakultetin e Drejtësisë dhe Departamentin përkatës të së Drejtës Civile dhe të Biznesit që janë strukturat përgjegjëse për ofrimin e këtij programi.			
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i kurrikulës së programit të studimit rezulton se ky program është i hartuar në përputhje me nevojat që ka vendi në këtë fushë specifike të së drejtës dhe dijet që ky program kërkon të ofrojë janë në përputhje me nevojat që ka tregu i punës.			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Ark Përbushjet	Përbushjet pjessërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga sa rezulton nga shqyrtimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit (2017-2021), program i studimit është në përputhje të plotë me planin zhvillimor te KUQ në tërsi dhe në veçanti me fushën akademike përkatëse duke patur si filozofi profilizimin e studentëve në lëmin e së drejtës së biznesit. Gjithashtu është me rëndësi fakti se ky program studimi thith studentë nga programi Bachelor në Drejtësi me profil E Drejtë Biznesi.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij	Nga verifikimi i dokumentacionit të DVV, konkretisht Statutit dhe Rrregullores së KUQ vihet re një përputhje me L. nr. 80/2015. Në bazë të këtyre akteve Senati akademik është organi më i lartë i cili			

	<p>dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> <p>vendos mbi hapjen, modifikimin apo riorganizimin e çdo programi studimi dhe është organi më i lartë i cili shprehet për propozimet e reja të ardhura nga njësítë bazë duke ushtruar kështu kontroll akademik, programatik dhe ligjor mbi jetën e institucionit dhe që programet e propozuara të janë në përputhje me drejtimet prioritare të vendosura për çdo njësi të KUQ.</p>								
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Në nenet 35 e në vijim të rregullores së institucionit janë përcaktuar qartë organizimi i programeve të ciklit të dytë të studimeve. Në dokumentat programatike (strategjite) program i studimit është në përputhje me drejtimet akademike që institucioni ka në filozofinë e tij.</p>								
	<p>Bazuar në DVV dhe në organigramën e KUQ rezulton një përputhshmëri midis emërtimit, organizimit, varësisë institucionale, strukturës dhe përbajtjes së programit me fushën akademike përkatëse. Programi i studimit MP në "Jursit me Drejtim Biznesi" ofrohet nga Departamenti i së Drejtës Civile dhe Biznesit, Fakulteti i Drejtësisë. Kjo njësi funksionon në bazë të rregullores të saj të ku përcaktohen grupe i lëndëve që mbulan, fushat kërkimore përkatëse dhe mënyra e menaxhimit të programit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor vihet re se program i studimit përmban edhe lëndë të formimit bazë të cilat ofrohen në bashkëpunim me njësi të tjera bazë të Fakultetit apo njësi kryesore brenda KUQ si Fakulteti i Ekonomisë.</p>								
	<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjite kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" data-bbox="599 1367 1429 1502"> <thead> <tr> <th>NDK përbushjet</th> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	NDK përbushjet	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht				X
NDK përbushjet	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht						
			X						

Standardi I.3

Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e</p>	<p>Bazuar në DVV që KUQ ka depozitur pranë ASCAL për vlerësimin e këtij program studimi sic janë dokumentat programatikë, rregulloret, plani mësimor etj, rezultojnë të qarta objektivat që duhet të arrihen nëpërmjet programit të studimit me qëllim që studenti që përfundon ciklin të jetë i aftë dhe ti përgjigjet nevojave të tregut të punës si dhe përcaktohen qartë mënyra sesi duhet të hartohet programi i studimit që në hartimin e planit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

tregut të punës.	<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombe tar të punës për programet e studimit që ofron, përparr hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitet e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>
	<p>mësimor deri te syllabuset e lëndëve të veçanta me qëllim arritjen e objektivave të KUQ. Në aktet e brendshme përcaktohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në syllabuse ngarkesa e punës individuale të studentit, ngarkesa në auditor, detyrat e kursit dhe punimi i diplomës (përcaktuar në planin mësimor).</p> <p>Megjithatë GVJ vlerëson se Suplementi i Diplomës, si një dokument thelbësor për përfshirjen e studentit në tregun e punës kombëtar dhe rajonal, mungon për programin e studimit në vlerësim. Suplementi i diplomës është dokumenti i cili shoqeron diplomën e studentit dhe listën e notave ku duhet të dalin qartë çdo objektiv dhe qëllim që ka IAL që e ofron programin e studimit dhe shpjegimi i detajuar i mënyrës sesi programi i ofruar ka formuar studentin (në programin përkatës) për të qenë pjesë e tregut të punës dhe përcakton qartë objektivat që arrihen nga programi dhe kompetencat që fiton studenti.</p> <p>Gjithashtu, edhe pse rezulton të jetë përcaktuar qartë në rregulloret përkatëse në bazë të vlerësimit të organeve akademike që kanë miratuar këtë program studimi brenda IAL, nuk kemi një analizë të thelluar dhe reale të tregut të punës e kryer mbi baza empirike për programin specifik të studimit (shiko Anex I_12).</p> <p>Nga shqyrtimi i Anex-it I.12 rezulton se analiza e tregut të punës nuk i përshtatet dhe nuk është e kryer për programin specifik të studimit duke mos patur parasysh qëllimin dhe objektivat që institucioni duhet të përndjekë kur ofron programin apo kur kryen ndryshime në planin mësimor në varësi të nevojave reale të tregut të punës. Në analizën e tregut të punës ka një mungesë të theksuar të nevojave reale që kanë operatorët në treg dhe sesi ky program mund të ndikojë në punësimin efektiv të studentëve, mungojnë pyetësorët apo vlerësimet empirike nga analiza e intervistave me punëdhënës të ndryshëm.</p>
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përbajtja e programave të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës, garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive, shkathësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	<p>Përsa i përket planit mësimor dhe syllabuseve, sidomos në lëndët karakterizuese vihet re një përputhje me objektivat që ky program studimi kërkon të arrijë për formimin e Juristëve në fushën specifike të biznesit, vihet re një mungesë e lëndëve me karakter procedural, të cilat nga sic u pohua dhe nga vetë stafi, po punohet për përmirësim dhe se do të përfshihen në planin e propozuar për vitin 2019-2020. Nga vlerësimi i kujdeshëm i syllabuseve vihet re në disa nga to përfshirja e hartimit të detyrave të kursit apo projekteve që e ndihmojnë studentin dhe e formojnë për tregun e punës.</p> <p>Programi i studimit MP “Jursit me Drejtë Biznesi” është i përafërt me programe të tjera të së njëjtës fushë në panoramën kombëtare, në rajon dhe në vendet e BE. Gjithsesi mbetet për tu theksuar se disa nga disiplinat e përfshira janë disiplina të formimit bazë sic është E Drejta Private, Ekonomiks Menaxherial apo nga fushta të tjera të përaferta që përbejnë veçanti të këtij programi studimi. Ajo cka GVJ konstaton është se nuk arrihet të kuptohet qartë përfitimi</p>

	<p>që studenti do të ketë me fitimin e krediteve në këto lëndë. Fakti i të qenurit i përafërt me programe të cilat ofrohen edhe nga IAL të tjera, bën të mundur transferimin e studimeve për studentët. Për më tepër kjo lehtëson edhe punësimin në tregje rajonale apo ndërkombëtare sipas parimeve të Kartës së Bolonjës. Problem mbetet mungesa e suplementit të diplomës e cila e vendos studentin në kushte që të mos ketë atë lirshmëri në lëvizje në programe të tjera studimi apo përshkrimin ekzakt të kompetencave që ai ka fituar në program me qëllim që ta demonstrojë tek punëdhënës potencialë.</p>
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	<p>Programi i studimit MP "Jurist me Drejtë Biznesi" rezulton të jetë i hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për arsimin e lartë, atë europian dhe në bazë të kërkesave të Urdhërave profesionalë përkatës (në rastin konkret DHKA dhe kërkesat që ka ajo për të patur akses tek profesiioni i avokatit) apo nevojave të operatorëve të biznesit.</p> <p>Mbarëvajtja e programit të studimit realizohet në bazë të akteve të brendshme të KUQ, sic janë, rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë, rregullorja e Departamentit të së Drejtës Civile dhe Tregtare si dhe rregulloren e programit të studimit.</p>
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	<p>Programi i studimit MP "Jurist me Drejtë Biznesi", referuar planit mësimor rezulton se ka në përbajtje të tij praktikë profesionale me qëllim që studenti një pjesë të aktivitetit ta zhvillojë pranë qendrave profesionale siç janë institucionet publike apo private dhe njëkohësisht të mbikqyret nga një udhëheqës dhe të rezultojë me një produkt final sic është disertacion i shkurtër mbi detyrat e kryera gjatë praktikës. Në vlerësimin e GVJ praktika profesionale duhej të ishte më e gjatë dhe më e strukturoar (gjithsesi jemi të vetëdijshëm për kërkesat e reja ligjore dhe reduktimin e masterave profesionale vetëm në 1 vit akademik dhe 60 ECTS). Në disa lëndë është e përshkuar në syllabuse se studentët do të aftësohen në mënyrë praktike mbi temat e ofruara.</p> <p>Në vlerësimin e GVJ, Klinika e ligjit e cila funksionon si njësi bazë pranë Fakultetit të Drejtësisë, duhet të jetë më funksionale, të ketë të përcaktuara gjyqe simuluese me qëllim aftësimin praktik të studentit. Këto aktivitete duhet të dokumentohen dhe të marrin një vlerësim studentët për angazhimin e tyre në praktikë.</p>
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Fusha specifike e këtij program studimi ka një dimension zhvillimor thelbësish ndërkombëtar dhe si e tillë do të ishte e lavdërueshme që pjesë e literaturës së detyrueshme të ishin dhe artikuj të fundit në anglisht. Megjithatë është e përcaktuara në syllabuse literature e rekomanduar në anglisht. GVJ vlerëson se duhet vërejtur mundësia e përfshirjes së moduleve apo lëndëve në anglisht.
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të	Ky program, duke u nisur nga formati që ofrohet, si dhe duke parë listën e institucioneve që bashkëpunojnë me KUQ, është

nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	i mundur ti ofrohet një target grupi të caktuar dhe në përiudha të caktuara.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti i Drejtësisë menaxhon programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë. Në lidhje me kapacitetet e nevojshme ky institucion ka kapacitetet e mjaftueshme midis PAE dhe PAK për të ofruar këtë program studimi por kjo arrihet dhe duke u nisur nga bashkëpunimi ndërdepartamental dhe me njësitë e tjera kryesore të KUQ. Në vlerësimin e burimeve njerëzore akademike dhe fushave përkatëse kërkimore apo backgroundit të studimeve të kryera mund të themi se kapacitetet për të ofruar këtë program studimi janë në kufirin e mjaftueshmërisë.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit MP “Jurist me Drejtim Biznesi” rezulton të jetë në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Drejtësisë së KUQ pasi vetë njësia kryesore është e orientuar drejt zhvillimit të rritys së saj drejt leimit të së drejtës private dhe ky MP është vijim i natyrshëm i programit Bachelor në “E Drejtë Biznesi”. Kodifikimi kombëtar i tij është bazuar në nenin 86 dhe nenin 125, të LALKSH (Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor). Në lidhje me kodifikimin e standartizuar progami është në linjë me VKM Nr. 41, date 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Nga analiza e Rregullores së Departamentit të së Drejtës Civile dhe Biznesit, nga analiza e paraqitur në lidhje me personelin e jashtëm dhe të brendshëm të angazhuar, rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë që e ofron. Gjithashtu vihet re një bashkëpunim i mirë ndërdepartamental (nisur nga numri i PAE dhe PAK të deklaruar nga Fakulteti) brenda fakultetit me qëllim realizimin me sukses të programit të studimit.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profitit të institucionit, cilësia e tij garantonhet nga institucionet partnere.	Nuk është rasti i këtij programi studimi dhe nuk ka të aktivizuar në këtë IAL masterat të kësaj natyre të cilat ofrohen me qëllim të caktuar apo sipas kërkesave specifike të partnerëve të IAL.
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Sic rezultoi edhe nga takimi me personelin akademik, në lidhje me bashkëpunimin brenda në institucion, vihet re një bashkëpunim i kënaqshëm për të trajtuar problematikat që kanë të bëjnë me vijueshmërinë dhe ofrimin e programit të studimit. Ekziston një bashkëpunim i ngushtë midis njësisë bazë dhe njësisë kryesore si dhe eficencë të vendimmarrjes së organeve kolegiale duke u nisur dhe nga numri i vogël i stafit. Në rregulloren e KUQ, dhe në rregulloret e njësisë kryesore FD dhe njësive bazë, departamentet përkatëse, janë përcaktuar qartë detyrat dhe detyrimet e secilit funksion. Gjithashtu KUQ ka dhe një rregullore për mënyrën e zhvillimit të mbledhjeve të asamblesë së stafit akademik. Sipas kësaj Rregulloreje asambleja e plotë e stafit duhet të mblidhet të paktën 3 herë në vit.</p> <p>I kënaqshëm është edhe bashkëpunimi me personelin ndihmës akademik dhe vënia në dispozicion e ambjenteve (si sallat, laboratorët informatikë apo biblioteka) në funksion të procesit mësimor.</p> <p>Analiza vjetore në njësitë përkatëse përgjegjëse është e kënaqshme dhe numri i mbledhjeve të njësive është i mjaftueshëm.</p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendo marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera universitare dhe nga bota e biznesit me qëllim përfitimin direkt të studentëve dhe aksesin sa më të kollajtë në tregun e punës. Gjithsesi bashkëpunimi institucional kryesisht mbetet në nivel kërkimor dhe i dedikuar për personelin (nuk ka marrëveshje në kuadër të Erasmus për shkëmbim studentor). Gjithsesi me interes është marrëveshja e bashkëpunimit për shkëmbime studentore me IPE (institut italian).
Kriteri 3. Për realizmin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimi të lartë vendo marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënesit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Bazuar në DVV rezulton se KUQ disponon marrëveshje bashkëpunimi për praktikën e studentëve me kompani ligjore apo institucione të ndryshme dhe në planin mësimor parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale e cila mbetet gjithsesi e reduktuar në 2 javë. Lista e institucioneve që KUQ bashkëpunon është e kënaqshme duke u përcaktuar qartë në disa marrëveshje fokusi i afritit të studentit me tregun e punës (kryesisht në marrëveshjet me komunitetin e biznesit, sidomos ka patur zhvillime praktike marrëveshja me kompaninë AlbJuris).
Kriteri 5. Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënesit.	Për sa i përket bashkëpunimit ndërinstitucional KUQ ka një sërë marrëveshjesh të cilat janë me fokus në kërkimin shkencor, duke

	patur si bazë organizimin e konferencave të përbashkëta. Ky bashkëpunim shtrihet brenda dhe jashtë vendit. Ndërsa përsa i përket trajnimeve profesionale apo moduleve të veçanta ofrohen nga institucioni vetëm leksione të hapura nga lektore të njohur të ftuar në fusha specifike.								
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nga vizita në institucioni GVJ u njoh se analiza dhe vendimmarrja në lidhje me marrëveshjet e bashëpunimit kryhet vetëm në rang njësie kryesore dhe në organet kolegiale drejtuese si Senati dhe më pas zbret në mënyrë kapilare në department. Duke u nisur edhe nga numri relativisht i kufizuar i marrëveshjeve ato menaxhohen në rang institucioni. Këto marrëveshje vijnë zakonisht duke u nisur nga kontaktet pësonale të stafit akademik dhe jo si një punë e strukturuar e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X		
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
	X								

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Një Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X		

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master Profesional “Jurist me Drejtë Biznesi”, është rishikuar, nga momenti i pezullimit të Institucionit, duke u bazuar në qëllimet, misionin dhe objektivat e Kolegjit Universitar “Qiriazi” (KUQ), të cilat janë të shprehur në planin strategik të zhvillimit të Kolegjit. Në vlerësimin e GVJ do ishte e nevojshme të përpunohej plani strategjik i lidhur me Fakultetin e Drejtësisë. Studimi i tregut të punës i cili edhe pse nuk është specifik për këtë program studimi, ka nxjerrë përfundimin se Masteri Profesional “Jurist me drejtë Biznesi” është një program i kërkuar veçanërisht nga juristë të cilët duan të përfitojnë studime të thelluara në fushën e biznesit, me qëllim punësimin pranë institucioneve publike dhe jo-publike, ose pranë organeve të administratës gjyqësore, në fushën e ndërmjetësimit dhe përbarimit, zyrave të avokatisë dhe noterisë, personave juridik dhe shoqërive tregtare private, sistemit bankar etj.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master Profesional” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Programi i studimit rezulton të jetë i plotësuar me elementët e nevojshëm për të qenë pjesë e një tregu kombëtar. Elementët përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet
Kriteri 3. Programi i studimit “Master Profesional” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	
Kriteri 4. Programi i studimit “Master Profesional” zhvillon	

	<p>njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> <p>(ECTS), metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara e bejnë ketë program të konkurueshëm në tregun kombëtar. Ky program studimi është i shtrirë në një vit akademik, me 2 semestra. Viti akademik ka një ngarkesë prej 60 kredite ECTS. Ndarja e lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi sipas veprimtarive formuese është nga A në E sipas udhëzimeve ligjore në fuqi (VKM nr. 41/2018). Programi i studimit Master Profesional në "Jurist me Drejtë Biznesi", është në përputhje me kornizat e paracaktuara ligjore.</p> <p>GVJ përgjatë takimeve në Insitucion, ka konstatuar se pedagogët përdorin metodologji akademike të përshtatshme me programin dhe aspektet praktike të tij. Siç është konstatuar, tematikat pasurohen me elementë bashkëkohorë duke patur edhe në vëmendje aspektet studimore të orientuar drejt praktikës sipas standardeve të një programi Master Profesional. Njohuritë teorike me aplikimin praktik lidhen direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës. Kjo për shkak të faktit që studentët janë të pakët në numër dhe në tërësi të punësuar.</p>								
<p>Kriteri 5. Programi i studimit "Master Profesional" përbën të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Bazuar në DVV, programi i studimit MP në "Jurist me Drejtë Biznesi" rezulton i strukturuar sipas kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi. Çdo modul ka të specifikuar kreditet (ECTS) në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë. Vlerësimi i studentit bazohet në detyrat e kursit individuale ose në grup, në provimet e ndërmjetme dhe elementë shtesë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Grupet e seminarit janë në përputhje me tabelën 2 të VKM Nr.41, Dt.24.01.2018, me pak se 35 studentë/grupi, duke qenë se numri total i studentëve për vit eshte i ulët. Zhvillimi i leksioneve dhe seminareve është i konceptuar në cikël unitar.</p>								
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master Profesional" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit MP në "Jurist me Drejtë Biznesi" rezulton të jetë i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite. Përcaktohen në të veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>								
<p>Kriteri 7. Programi i studimit parashikojne ngarkesen ne kredite te dedikuara per praktiken profesionale , laboraterike e klinike me ekuivalentimin sipas percaktimeve ne aktet nenligjorekombetare dhe ne perputhje me dërektivat evropiane.</p>									
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" data-bbox="572 1686 1421 1821"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore përvlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Drejtësisë në KUQ organizohet në tre njësi bazë që janë: Departamenti i së Drejtës Civile dhe Biznesit, Departamenti i së Drejtës Publike dhe Administrative dhe Klinikën Ligjore dhe Kërkimore. Përsa i përket vitit të fundit akademik, 2018-2019, bazuar edhe në shkresën 143/2 Prot. Date 07.05.2019, dhe evidencat e kërkua gjatë vizitës në Institucion (Evidenca 3), Departamenti i të Drejtës Civile dhe Biznesit përbush kriteret e përcaktuara në LAL 80/2015, dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Rezultojnë të paktën 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët 3 me tituj. Rregullorja e Institucionit përcakton detyrat dhe përgjegjësitë në departament.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Bazuar në DVV, plani mësimor i dorëzuar nga Institucioni nxjerr në pah faktin se lëndët referuar programit të studimit nuk mbulohen nga Personel Akademik Efektiv në masën 70%. Ky kriter rezulton jo në përputhje me kërkuesat ligjore ku personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve. Të dhënat e vëna në dispozicion nga Institucioni tregojnë se ky numër pedagogësh, mbulan ngarkesën akademike në të dyja departamentet. Kjo justifikohet, siç u konfirmua përgjatë takimeve me strukturat drejtuese të KUQ, nga numri i vogël i studentëve.
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Referuar ligjit për arsimin e lartë nr. 80/2015, rezulton se Dekani i këtij Fakulteti zoteron titullin akademik Profesor i Asociuar, ndërsa Përgjegjësi i Departamentit kanë gradën shkencore Doktor Shkencash, në mungesë pedagogësh të tjerë me titull. Kriteret ligjore rezultojnë të plotësuara pavarësisht se këshillohet avancimi i mëtejshëm akademik i stafit në tituj dhe pozicionimi në pozicionet drejtuese.
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Nga shqyrtimi i DVV, rezulton se Departamenti i së Drejtës Civile dhe Biznesit ka në dispozicion personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, dhe zhvillimin e tyre në klinikën ligjore të institucionit. Numri aktual sipas informacioneve të mbledhura rezulton të jetë 2 personel ndihmës.
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Roli i koordinatorit është i parashikuar në aktet rregullative të KUQ-së, por rezulton të mos jetë realisht funksional. Përgjegjësja e Departamentit, siç i është konfirmuar GVJ edhe gjatë vizitës në Institucion, koordinon edhe këtë detyrë shtesë. Numri i vogël i studentëve ka justifikuar këtë zgjedhje.
Kriteri 7. Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Roli i Koordinatorit të programit të studimit rezulton të jetë ndihmës ndaj Përgjegjësit të Departamentit sepse çdo fund semestri ose çdo fund muaj raporton tek ky i fundit në lidhje me ecurinë e programit dhe realizimin e objektivave të tij. Ndër të tjera Koordinatori angazhohet në mbikqyrjen dhe monitorimin për realizimin e programit mësimor si dhe praktikat profesionale në përputhje me objektivat. Duke qenë se dy figurat rezultojnë të shkrira në një të vetme, sugjerohet të caktohet një

	anëtar tjetër departamenti në rolin e koordinatorit të programit duke e larguar këtë rol nga Përgjegjësi i Departamentit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet përcaktuesht	Përbushet pjessërisht	Përbushet kryesish	Përbushet plotësisht

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në DVV, njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë MP "Jurist me Drejtë Biznesi", disponon në tërësi informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit. Në veçanëti elementët e sipërpërmëndur gjenden në: <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren e Fakultetit - Rregulloren e Departamentit - Dosjen programit të studimit (plani mësimor) - Planin strategjik për zhvillimin e Fakultetit - Organigramën e Fakultetit - Të dhënat e stafit akademik, (CV, ngarkesa mësimore) - Syllabuset për lëndët e zhvilluara në këtë program studimi.
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	RVB evidenton se programi MP "Jurist me Drejtë Biznesi" është organizuar në 5 kategori lëndësh me 60 kredite. Posaçërisht: A. Lëndë të formimit të pergjithshëm e metodologjik - reth 10%, B. Lëndët karakterizuese (për Biznesin) – 40 % C. Lendët ndërdisiplinore/integruese - me 26 % D. Lendët plotësuse me 15%, E. Lendët përbyllese (Mbrojtja e Diplomës) me 9 % GVJ-ja gjatë vizitave në Institucion u informua se praktika zhvillohet në institucione me të cilat KUQ ka marrëveshje bashkëpunimi.
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Nga informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i DVV dhe vizitës në institucion, rezulton se MP "Jurist me Drejtë Biznesi" është i organizuar në lëndë mësimore, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) të organizuara në semestra.
Kriteri 4. Programi i studimit përban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Bazuar në RVB dhe DVV, planet mësimore të dorëzuara përbajnjë informacionet e nevojshme rreth programit dhe numrit të krediteve për çdo lëndë. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e secilës lëndë përcaktohet, frekuentimi në leksion dhe ai në seminar, mënyrën e vlerësimit të dijeve. Konkrektisht, frekuentimi në leksione është 50% dhe në seminarë 75%. Mënyra e vlerësimit për pjesëmarrjen dhe aktivizimi gjatë seminareve është 10% ose 10 pikë, provimi i ndërmjetem (me shkrim) 20% ose 20 pikë pas javës së 7-

	të, detyrë kursi 10% ose 10 pikë dhe provimi përfundimtar 60% ose 60 pikë. Në total zhvillohet 15 javë mësimore, ku vlerësimi është 100 pikë dhe vlerësohet më notën maksimale 10 dhjetë.
Kriteri 5. Programi i studimit përban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Institucioni ofron informacion për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Numri i vogël i faciliton komunikimin.
Kriteri 6. Programi i studimit përban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit	Informacioni në syllabus rezulton konform praktikave të mira dhe përban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit
Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Programi MP “Jurist me Drejtë Biznesi” është nën vëzhgim të vazhdueshëm në kuadrin e përshtatjes me nevojat e tregut dhe në kuadrin e specifikës së progremit. Nuk rezulton dosje në anglisht.
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxenit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master Profesional” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Sic përcaktohet edhe në RVB, në programin e studimit Master Profesional, ngarkesa mësimore është deri diku ne perputhje me aktet ligjore, megjithes mbetet kontrakditore ngarkesa referuar punimit të diplomës dhe praktikës profesionale.
Kriteri 2. Emërtimi, përbajtja e veprimitarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxenit dhe aftesimit profesional .	Programi i studimit ashtu siç është konceptuar, në strukturimin e përgjithshëm semestral dhe caktimin e lëndëve sipas ndarjes në module i qaset një standarti të kënaqshëm në arritjen e objektivave formues të Masterit Profesional me rezultate potencialisht të kënaqëshme të të nxenit. Materiali formues në tërësinë e tij shfaqet në përputhje me orientimin e programit, që mbetet i gjerë duke qenë se ka objektiva formuese në tërësinë e së drejtës së biznesit.

Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë eshtë në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngashme ndërkombëtare.	Struktura e programit pasqyrohet qartë dhe me rezultate të kënaqëshme në konturet e emërtimit dhe qëllimin për të cilën eshtë krijuar programi i studimit. Sa i përket perputhshmerisë me programet ndërkombëtare, ka tendeca per perafrimin me to.								
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit MP "Jurist me Drejtim Biznesi", ndërtohet mbi veprimtaritë formuese duke u kategorizuar sipas tipologjive që janë të kategorisë A, (lëndët bazë), të kategorisë B (lënde karakterizuese) të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore), të kategorisë D (lëndë plotësuese) dhe të kategorisë E (detyrimet myyllëse (Punimi i diplomës). Kjo sjell një qasje praktike me elementët e nevojshëm logjik të mendimit dhe profesionalizmit të kërkuar nga tregu shqiptar. Në këtë mënyrë shtohen mundësitet e avancimit të mëtejshëm profesional ose akademik të studentit.								
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Referuar syllabuseve të lëndëve, rezulton se ato karakterizohen nga një thellim i mjaftueshëm duke reflektuar gjithashtu elementët përbajtësor të nevojshëm për përfitimin e koncepteve bazë në funksion të të nxënës. Literatura e ofruar është e pasur dhe reflekton tentativat e stafit akademik dhe të institucionit për pasurimin e studentit.								
Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Përbajtja e përgjithshme e programit të studimit MP "Jurist me Drejtim Biznesi", lejon vijueshmërinë në profesionet juridike të cilat kërkojnë formimin e posaçëm juridik në fushën e së drejtës se biznesit, pavarësisht se kjo e fundit do të kërkonte ende thellim. Studimi i tregut të punës ofruar nga Institucioni mundëson dhe lehtëson edhe më tej aksesin në profesion. Megjithatë në vlerësimin e GVJ, KUQ duhet të ndërmarrë një studim tregu më specifik për sa i përket programit të studimit në vlerësim.								
Kriteri 8. Përbajtja e programit të studimit siguron aftesi, kompetenca dhe thellim te formimit prorfesional.	Bazuar në DVV, studimi i tregut të punës nga ana e Institucionit tregon vëmendje të veçantë kundrejt formimit profesional të studentit. Numri i pakët i studentëve dhe fakti që në tërësinë e tyre studentët janë tashmë të punësuar, dobësojnë nevojën e thellimit në këtë drejtim. GVJ konstatoi gjatë vizitës sidoqoftë, që KUQ konsultohet me bizneset private për nevojat e tregut.								
Shkalla e përbushjes së standartit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë	Pedagogët e lëndëve në programin e studimit, për vitin akademik

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	2018-2019, MP “Jurist me Drejtë Biznesi”, janë 1 me titullin “Profesor”, 3 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 5 me gradën “Doktor”. Sipas pikes 3 te nenit 56 te LAL 80/2015, titullarët e lëndeve duhet të janë të kategorisë Profesorë të Asociuar ose Profesorë, kështu që kjo pikë rezulton pjesërisht e papërbushur, duke qenë se, nga 9 lëndë të programit, disa prej tyre titullarëve mbajnë gradën shkencore “doktor”.								
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master Profesional”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.									
Kriteri 3. Niveli I kualifikimit dhe Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Ekspertiza e pedagogëve varion në fushën e së drejtës duke i dhënë mundësi Departamentit të përzgjedhë në shumëlojshmérinë e formimit akademik të pedagogogëve. Megjithatë numri i vogël i tyre krijon edhe situata të tilla që pedagogët në disa raste devijojnë ekspertizën e tyre në fusha të përaferta të se drejtës. Pra GVJ bazuar në CV e stafit akademik, është përballur me situata ku stafi lektron lëndë jo në përputhje të plotë me profilin e tyre akademik.								
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucionet e tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në disposicion personelin e mjafqreshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimitari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ka personel të mjaftushëm për ndjekjen e praktikave duke qenë se numri i studentëve është shumë i vogël, praktikisht 4 studentë. Nga vizita e GVJ u reflektua se të gjithë studentët pjesë e programit të studimit MP “Jurist me Drejtë Biznesi” rezultojnë të punësuar. Përsa i përket marrëveshjeve të bashkëpunimit, rezulton se aktualisht KUQ ka një marrëveshje bashkëpunimi me një Institucion Italian. Kjo marrëveshje i është vënë në disposicion GVJ sipas kërkesës specifike bërë gjatë vizitës.								
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe përmirëmbajtjen e laboratorëve e mjetëseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Pavarësisht natyrës praktike të programit, fusha juridike nuk kërkon angazhim të posaçëm mbi këtë pikë, përvèç metodave të veçanëta të mësimdhënies, jo të detyrueshme për arritjen e një standardi të kënaqshëm. Pavarësisht se KUQ nuk ofron laboratori, Institucioni ka në disposicion edhe një personel ndihmës mësimor-shkencor i cili angazhohet në detyrat administrative të përgjithshme për realizimin e orëve mësimore dhe mirëmbajtjen e mjetëseve ku zhvillohen këto orë mësimore.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nd</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nd	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X		
Nd	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
	X								

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbushjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat	Nga vizita në institucion dhe DVV rezulton se, Departamenti i së Drejtës Civile dhe Biznesit, përgjegjës i programit MP “Jurist me Drejtë Biznesi” ka hedhur bazat e një komunikimi të shëndetshëm

Adresa: “Ruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	profesional me aktorët e tregut të punës. Në KUQ ka vëmendje të vazhdueshme ndaj transformimeve të tregut të punës të cilët janë propozime shërbejnë për përmirësimin e përmbajtjes së programit. Studimi i tregut të punës i hartuar nga KUQ është një fakt i kësaj veprimtarie.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët GVJ u njoh, se në fund të programit të studimit MP "Jurist me Drejtë Biznesi" realizohen konsultime dhe pyetësorë me studentët për cështjet e përgjithshme institucionale, përfshirë edhe programin e studimit. Këshillat dhe sugjerimet e tyre konsultohen dhe reflektohen në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Përfaqësimi i studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese si këshilli i fakultetit dhe senati akademik i KUQ nuk është pasqyruar konform akteve rregullative, por ky element justifikohet nga numri i vogël i studentëve në Institucion dhe mundësia e konsultimit direkt.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Institucioni disponon një Zyrë Këshillimi të Karrierës, por që nuk ka një traditë të gjatë të mbajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar.
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucion publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme ne perputhje me kerkesat dhe nevojat specifike locale dhe zhvillimi.	Institucioni është në hapat e parë në zhvillimin e bashkëpunimit me institucione publike e private dhe përgjithësisht zhvillon aktivitete të përgjithshme me karakter të vecantë, sic i është referuar GVJ-së gjatë vizitës në Institucion.
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet Përmbushet pjesërisht Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë hartron udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në DVV rezulton se KUQ disponon udhëzuesin për kualifikimin e stafit akademik dhe mënyrën e funksionimit të mbikqyrjes së proçesit të mësimdhënies dhe gjithashtu ka një platform e-learning për të bërë të mundur në distancë komunikimin pedagog student. Institucioni ofron përgjatë ciklit të studimit jo vetëm leksione

	frontale por edhe organizime akademike në rang institucioni apo programi si leksione të hapura, leksione me të ftuar apo seminare thelluese. KUQ disponon gjithashtu edhe një dokument programatik ku përcakton politikat për vlerësimin e brendshëm.								
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni ka ngritur mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit të cilat kryejnë vlerësimin e personelit. Puna e personelit vlerësohet në vijimësi dhe monitorimi i takon njësisë bazë dhe ka në përfundim një vlerësim për çdo lektor nga drejtuesi i njësisë. Formati i vlerësimit të punës së PAE dhe PAK është cilësor. Në KUQ ekziston dhe NJSBC e cila në teori kryen një vlerësim të pavarur dhe njëkohësisht monitoron mbarëvatjen e procesit mësimor dhe aktivitetin e ofrimit të programit. Gjithsesi përbërja e grupit të NJSBC nuk është në përputhje me kërkosat ligjore për pavarësi të përbërësve dhe mungon përfshirja në të e një pësoneli administrativ. Format e monitorimit janë ato klasiket nëpërmjet miratimit të syllabuseve, kontolleve dhe pyetësorëve të studentëve. Megjithatë pyetësori tip për studentin ka nevojë për përmirësimë qoftë në numrin e pyetjeve qoftë në mënyrën e formulimit të pyetësorit. Studentët përfshihen në procesin e monitorimit me pjesëmarjen e një përfaqësuesi të tyre në NJSBC.								
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e gjetjet apo analiza e punës vjetore të NJSBC nuk bëhen publike dhe nuk kemi një dokument përfundimtar analistik ku të vlerësohet leximi i anketimit të studentëve. Analiza vjetore bëhet dhe diskutohet në nivel njësie bazë dhe kryesore dhe pasqyrohet tek raporti vjetor. Gjithsesi kjo analizë nuk është plotësisht e detajuar ku të dalin qartë rezultatet e vlerësimit. Analiza e punës së çdo antari të personelit mësimdhënës kryhet në nivel njësie bazë dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore. Mungon gjithsesi një pasqyrë e detajuar në një raport vjetor nga ana e njësive të KUQ. Formulari i vlerësimit të personelit akademik gjithesi është i kompletuar.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushjet publike</th> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushjet publike	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht		X		
Përbushjet publike	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht						
	X								

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e	Nga vlerësimi i kujdeshëm i planit mësimor dhe syllabuseve vihet re një shpërndarje e drejtë e ngarkesës në orë leksioni/seminare dhe ngarkesa e studimit individual për çdo student është e shpërndarë

klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjeter e miratuar nga institucioni.	mirë. Studentët duhet të përgatisin detyra kursi apo projekte individuale në lëndë të ndryshme.								
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Komunikimi me studentët është korrekt dhe raporti pedagog-student është cilësor. Pasja e një numri të kufizuar studentësh sjell dhe një përkujdesje të shtuar të pedagogëve qoftë në drejtim të tutorimit dhe shpjegimit apo qartësimit të koncepteve jashtë auditorit. Siç e theksuan tutorimi është funksional dhe efektiv.								
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni ka një nr marrëveshjesh me IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit megjithatë përiudhat e shkëmbimit të pedagogëve, qoftë dhe me fonde të KUQ nuk ka dhe mungojnë shkëmbimet Erasmus. Institucioni duhet ta ketë më në fokus dërgimin institucional jashtë vendit të personelit të tij. KUQ i krijon lehtësira personelit me qëllim arritjen dhe ndjekjen e kualifikimeve të tyre akademike dhe mbështet stafin për pjesëmarrje në evenete akademike brenda dhe jashtë vendit.								
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik është kompetent në lidhje me programet e studimit megjithëse vihet re në disa raste mospërputhje e fushës kërkimore të lektorit, pra me lëndën specifike që ai mbulon megjithëse syllabusi është i plotësuar mirë.								
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi periodik i procesit mësimor kryhet nga ana e institucionit nëpërmjet kontrolleve të drejtuesve të njësisë bazë dhe njëkohësisht duke kryer anketimin e studentëve. Gjithsesi formaluri i anketimit është shumë i shkurtër dhe jo i elaboruar qartë në përbajtje.								
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Përdoren gjatë mësimdhënies metoda bashkëkohore dhe infrastruktura është e një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e seminareve, diskutimeve (ka salla me vendosjen e tavolinave rrëth dhe jokonvencionale) apo për prezantimin e projekteve.								
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga takimi me studentët rezulton se respektohet individualiteti i studentit dhe përkushtimi apo vullneti i tij ndaj tematikave të veçanta për diskutim. Kjo respektohet dhe në zgjedhjen e temave për detyra kursi qoftë në punën me projektet e kursit në grup.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nuk përmirëson</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmirëson	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përmirëson	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.3

Njësítë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin

profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	MP "Jurist me Drejtë Biznesi" zhvillohet në hapësira të përshtatshme, mjaft cilësore dhe të mirëmbajtura. Ambientet si salla leksionesh, salla seminaresh, biblioteka apo facilitate të tjera janë të pajisura me logistikën e duhur mësimore si pc, projektor dhe janë me komfortet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor. Edhe laboratorët ndihmës për personelin akademik dhe studentët janë në gjendje të mirë dhe funksionale.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	KUQ ka për programin mësimor platformën Web që është e aksesueshme nga pedagogët dhe studentët (E-Learning).
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Literatura e paraqitur në syllabuse (ajo e detyrueshme dhe fakultative) gjendet me lehtësi në treg dhe njëkohësisht KUQ ka marrë masa që të ndodhet dhe fizikisht në Bibliotekën e KUQ në disa kopje që është në dispozicion të studentëve. Mungojnë abonimet në biblioteka dixhitale dhe ato të aksesueshme janë vetëm bibiotekat dixhitale pa pagese por link për to nuk ka në Web-in e KUQ.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka garanton një numër të kënaqshëm botimesh. Nga vizita në institucion dhe biseda me stafin dhe studentët nuk është e institucionalizuar menjyra e pasurimit të biblioteksës me kërkesa nga njësia bazë por realizohet direkt nga njësia kryesore me kërkesë të tituje të librave që kanë shprehur interes kryesisht lektorët. Për programin e studimit ekzistojnë një numër i plotë i botimeve të AlbJuris që janë kryesisht botime profesionale.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë librari të on-line të fushave të ngjashme ose të përafërtë me programin e studimit.	Mungojnë abonimet në biblioteka dixhitale dhe ato të aksesueshme janë vetëm bibiotekat dixhitale pa pagese por link për to nuk ka në Web-in e KUQ.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Infrastruktura laboratorike dhe postet e punës me PC janë në nivel të kënaqshëm dhe të mjaftueshme për numrin e studenetëve të KUQ.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	KUQ përdor platformën online E-learning në të cilën aksesohet në mënyrë të pavarur stafi dhe studentët. Informacioni për stafin dhe studentët për përdorimin e platformës është i mjaftueshëm dhe platforma aksesohet direkt nga Web-i i KUQ.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në	

Adresa: "Ruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.				
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Duke u nisur nga numri i studentëve personeli akademik është i mjaftueshëm për ti ndjekur ato efektivisht dhe për ti udhëhequr në punimet e diplomës. Problem paraqet parashikimi se studentët që mund të mbrojnë diplomën janë ato me mesatare mbi 9 e cila nuk gjen reflektim në asnjë nga Rregulloret qoftë të Departamentit qoftë të programit të studimit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon strukturën njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinjnë dhe bashkërendojnë me njësitet kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Analiza kryhet në nivel njësie bazë dhe kryesore e cila i përcillet Rektoratit megjithatë institucioni ka ngritur dhe një strukturë të pavarur me rregulllore funksionimi siç është NJSBC e cila ka funksione monitorimi. Nga vizita në institucion u vërejt se antarët e zgjedhur në Njësi kanë edhe detyra funksionale drejtuese njëkohësht. Kjo bie ndesh me parimin e pavarësisë dhe misionin që NJSBC duhet të ketë brenda një IAL. Gjithashtu në përbërje të NJSBC mungon pjesmarrja e personelit administrativ.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia që menaxhon programin dhe njësia kryesore kryen, përvèç ofrimit të programit, edhe mbikqyrjen e zhvillimit të tij sipas standardeve të cilësisë. Kjo mbikqyrje zhvillohet me anë të kontrolleve periodike të strukturave drejtuese, miratimit të syllabuseve, etj sipas përcaktimve në Statut dhe Rregullore. Në KUQ nuk ka NJSBC në njësinë kryesore por vetëm në rang institucioni.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Personeli akademik kryen kërkim të vazhdueshëm shkencor por kjo është e organizuar në mënyrë të pavarur për çdo antar të pësonelit. Personeli mbështetës, nga bashkëbisedimi gjatë vizitës, deklaron se është i angazhuar në përditësimin dhe rritjen e tyre profesionale duke marrë pjesë vazhdimisht në trajnime dhe seminaret e organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Agjencitë e saj sipas sektorëve përkatës. Gjithsesi në dokumentacionin e zyrave administrative përkatëse (pranë Rektoratit, zyra e marrëdhënieve me jashtë) nuk ekzistojnë korrespondencë apo urdhëra në lidhje me delegimin apo caktimin e detyrës ndaj stafit për pjesëmarrjen në këto trajnime apo takime.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht	Në mbledhjet e njësisë bazë zakonisht personeli që sapo ka

personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>përfunduar një vizitë kërkimore apo një kumtesë në konferencë relaton mbi rezultatet e punës së arritur. Gjithsesi ka mungesë në dokumentacion ku nuk parashikohen relacione me shkrim nga ana e personelit për vizitën e kryer dhe eksperiencën e fituar. Mungesë është pjesmarrja në kuadër të programeve Erasmus apo edhe aplikimi individual i stafit për periudha kërkimore në universitetet partnere.</p>								
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	<p>Personeli akademik tregon përgjegjshmëri në zbatimin e programit të studimit duke hartuar syllabuse të sakta dhe me literaturë mbështetëse të mjaftueshme. Gjithashtu, personeli akademik është i prirur të zhvillojë mësimin dhe e zhvillon me anë të teknikave dhe metodave bashkëkohore dhe kjo u evidentua nga takimi me stafin akademik.</p>								
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësิตë përgjegjëse.	<p>Megjithëse në takimin me përgjegjësin e Departamentit na u sqarua se mbledhjet janë të shpeshta nuk na rezulton se debati në department kryhet dhe mbahet një protokoll përkatës. Komunikimi i risive dhe i mbarëvatjes së procesit kryhet por nuk ka një analizë të thellë në organet kolegiale.</p>								
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në fazë të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	<p>Në institucion angazhohen në mënyrë periodike lektorë të jashtëm por nuk ka një plan të detajuar vjetor nga njësia bazë apo ajo kryesore për lektorët e ftuar dhe temat që ato do relatojnë në kuadër të këtij programi studimi.</p>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: center; padding: 2px;">Nuk përbushet</th> <th style="text-align: center; padding: 2px;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="text-align: center; padding: 2px;">Përbushet kryesisht</th> <th style="text-align: center; padding: 2px;">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center; padding: 2px;"></td> <td style="text-align: center; padding: 2px; font-size: 2em;">X</td> <td style="text-align: center; padding: 2px;"></td> <td style="text-align: center; padding: 2px;"></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X		
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
	X								

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit të njojurive janë të qarta dhe të përcaktuara në Rregulloren e programit dhe reflektohen në çdo syllabus lënde. Në këtë mënyrë ato i bëhen të njoitura studentit, qoftë koha dhe mënyra e kryerjes së kontrollit të vazhdueshëm qoftë mënyra e zhvillimit të provimit përfundimtar.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi në Institucion rezulton se Studentët e kanë të qartë informacionin në lidhje me metodologjinë e vlerësimit dhe ka një uniformitet midis syllabuseve përsa i përket mënyrës së zhvillimit të provimeve dhe kryerjes së vlerësimit të ndërmjetëm.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njojuritë dhe kompetencat e fituara.	Parashikimi i kryerjes së testimit dhe vlerësimit të njojurive, shlyerja e detyrimeve akademike të studentit realizohet nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm, aktivizimit, paraqitjes së detyrave të kursit, etj.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë viti akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Testimi realizohet në format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit përfundimtar duke arritur në një mbledhje matematikore për vlerësimin e studentit në shlyrjen e detyrimeve përkatëse akademike. Ndarja e masës së vlerësimit në syllabuse duket e drejtë përvèç mënyrës së llogaritjes së vlerësimit të pjesëmarrjes së studentit dhe aktivizimit gjatë procesit mësimor (10% e vlerësimit)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë formën të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni nuk kryen testime online për studentët dhe forma e kryerjes së provimit është ajo klasike në auditor.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimi përfundimtar zhvillohet sipas përcaktimeve në rregulloren e KUQ dhe komisionet janë së paku me dy antarë (siç rezulton dhe nga vizita në institucion ku procesverbalet ishin të rregullt me dy antarë komisioni). Gjithsesi nga përgjegjësi i njësisë bazë nuk kemi një dokument miratimi komisionesh që të bëhen të njoitura paraprakisht. Testimet hartohen nga titullari dhe miratohen nga përgjegjësi i njësisë bazë.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njojurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi përfundimtar lejohet me shkrim apo me gojë dhe i kombinuar por nuk parashikohet në rregullore një procedurë e saktë për sekretimin dhe kush e kryen atë.
Kriteri 5. Vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënët për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi shoqërohet me komente vetëm gjatë vlerësimit të vazhdueshëm ndërsa në provimin përfundimtar ky feedback kryhet nga diskutimi midis lektorit dhe studentit në lidhje me metodologjinë e vlerësimit vetëm në rast ankimore.
Kriteri 6. Njësitet përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Personeli në KUQ është në dijeni për mënyrën sesi duhet të trajtojë plagjiaturën. Në KUQ kjo është e përfshirë të veprimitaria e Këshillit të Etikës dhe është edhe miratuar një Udhëzues për Punimin e Diplomës me qëllim shbangjen e plagjiaturës nga ana e studentëve.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale	Rezultatet e kontrollit jepen në kohë dhe për studentin është e qartë

bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	mënyra e grumbullimit të pikëve dhe vlerësimit. Rezultatet e provimit publikohen në platformën online dhe studenti e ka të mundur aksesin nga faqja personale. Ka paqartësi midis Rregullores së KUQ neni 65 dhe Rregullores së FD neni 67 e Rregullores së DDCB neni 35 për mënyrën e trajtimit të ankesave të studentëve nëse është përgjegjës Drejtuesi i Departamenti apo Dekani.								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Gjithsesi regjistri i ankesave i mbajtur pranë Dekanatit përbën risi. Në lidhje me këtë pikë nuk ka patur ndonjë praktikë konkrete në institucion.								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.									
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit MP "Jurist me Drejtë Biznesi" ka një shpërndarje të drejtë të lëndëve përkatëse por mungon në plan parashikimi i lëndëve me karakter procedural (që sipas diskutimeve me takimin me stafin do të përfshihen në vitin në planet e ardhshme mësimore duke e njohur si mangësi). Por në përgjithësi programi paraqitet në ofrimin e një ngarkese cilësore për studentin. Nga një analizë e hollësishme e syllabuseve vihet re një angazhim me studentin nëpërmjet detyrave të kursit që e thellojnë në tematika të veçanta të çdo lënde dhe që mundësojnë aftësimin praktik të studentit për të kryer kërkim të pavarur.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në program vihet re një shpërndarje midis lëndëve të kategorive të ndryshme dhe lëndët e formimit karakterizues janë të përcaktuara drejt. Gjithashtu syllabuset përcaktojnë qartë dhe literaturën mbështetëse në gjuhë të huaj.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Theksimi në syllabus i kompetencave që kërkohen të fitohen nga studentët trajtohen nëpërmjet metodave të mësimdhënies së përcaktuar në syllabuse dhe analizohen dhe ripërsëriten në fund të lëndës nga ana e pedagogut.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin	Edhe kontrolli i dijeve dhe vlerësimi i vazhdueshëm kanë lidhje me arritjen e qëllimit që pedagogu vendos në fillim në syllabusin e lëndës. Nga takimi që GVJ realizoi me studnetët dhe me stafin akademik dolë në pah se konsultimi final bëhet nga ana e pedagogut i cili shpejgon kush ishte qëllimi i temave të trajtuarë në javët e mëprshme, çështjet më me rëndësi të lëndës dhe vendin që do të zenë temat më të

përfundimtar.	rëndësishme në testimin përfundimtar.								
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga takimi me Dekanin dhe Përgjegjësen e departamentit GVJ u njoh se, përgjatë vitit akademik angazhohen në institucion lektorë të ftuar dhe organizohen edhe takime jashtë planit mësimor. Por mungon një planifikim vjetor që në fillim i leksioneve të hapura apo ditëve akademike.								
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njojuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Nga vizita në institucion dhe nga analiza e syllabuseve, duke u nisur dhe nga numri i kufizuar i studentëve në klasë është plotësishët e mundur të testohen metodat e reja të mësimdhënies sidomos në orën seminareve duke nxitur studentin për diskutime rreth një teme dhe duke punuar individualisht me to. Gjithsesi kjo qasje mbështetet dhe nga garantimi i infrastrukturës moderne si salla të përshtatshme të organzuara në hapësira të bollshme, projektorë, laborator IT etj. Studentët nxiten të marrin pjesë përgjatë organizimit të konferencës dhe të ndjekin punimet e saj. Mungon mbështetja financiare e iniciativave të studentëve apo organizimi i konferencave studentore apo prezantime të vazhdueshme të studentëve përpara trupës akademike të njësisë bazë.								
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.									
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.									
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet finanziarish ato.									
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Përgjatë vitit akademik studentët kanë mundësi të vëzhojnë nga afër dhe të marrin pjesë në shumë operatorë të tregut si psh AlbJuris. Nuk kemi akoma arritje nga ana e institucionit përsa i përket mobilitetit studentor.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të quartë të zbatimit të njojurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfshimit të njojurive, garantojnë mqedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Fakulteti dhe Departamenti që mbulon programin e studimit MP "Jurist me Drejtë Biznesi" janë të vendosur në pozicion të favorshëm brenda KUQ. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të përshtatshme. Gjithashtu KUQ ka ngritur dhe klinikën e ligjit. Praktika profesionale zhvillohet kryesisht jashtë institucionit në operatorët që bashkëpunojnë me KUQ.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njojurive dhe	Studentëve u ofrohet një listë e mjaftueshme me institucionë apo operatorë privatë ku mund të kryejnë praktikat. KUQ ka gjithashtu edhe Klinikën Ligjore e cila i shërben studentëve per rezlizim e praktikave.

Adresa: "Ruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tirana

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale në këtë program studimi vlerësohet nga një pedagog mbikqyrës dhe vlerësohet me kredite ECTS. Ekziston dokumentacioni i përpiluar nga ana e institucionit ku studenti kryen praktikën, ka një pedagog mbikqyrës të procesit megjithatë mungon dokumenti i studentit (psh. tema e praktikës me një analizë SWOT).			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studentët në MP "Jurist me Drejtim Biznesi" diplomohen duke mbrojtur një temë diplome apo me provim përfundimtar. Në rregulloren e programit neni 16 përcaktohet se diplomimi mund të bëhet me mbrojtje diplome apo me provim formimi. Modeli i provimit të formimit i bëhet i qartë studentit sipas Rregullores KUQ të paktën 1 muaj para (neni 83). Gjithsesi ka mospërputhje ndërmjet akteve të brendshme rregulluese të KUQ (shiko përcaktimet e Rregullores në nenin 83 që lejon përfundimin e studimeve me provim formimi vetëm për ciklin e parë ndryshe nga sa parashikohet në rregulloren e studimit)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat akademike dhe administrative i japin ndihmën e duhur studentit që përgatit diplomën apo kryen provimin final sipas përcaktimeve të rregullores.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësishë dhe peshës specifike.	Ka një përcaktim të qartë për mënyrën e vlerësimit nga ana e Komisionit të posaçëm në Rregulloret përkatëse.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Nga takimi me përgjegjësen e njësisë bazë rezulton se në mbledhje të njësisë bazë përcaktohen udhëheqjet e diplomave dhe studentit i përcaktohet pedagogu me fushën ku ai ka dëshirë të thollohet në punimin e diplomës. Udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përgatitjen e temës së diplomës sipas rregullores se FD.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjeshtëri e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni i jep mbështetje studentit në përgatitjen e punimit final duke i vënë në dispozicion udhëheqësin, bazën materiale, aksesin në laboratore apo bibliotekë ndërsa shpenzimet e tjera për procesin kërkimor i mbeten studentit.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston	

studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në bazë të Rregulloreve por edhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion me stafin dhe studentëve del qartë se udhëheqësi ndjek efektivisht (janë të përcaktuara qartë numri minimal i takimve midis udhëheqësit dhe studentit gjatë punimit të diplomës) dhe punon ngushtë gjatë përgatitjes së temës së diplomës. Studenti mund ta paraqesë punën për vlerësim përpara komisionit vetëm pas miratimit të udhëheqësit.								
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studenti vlerësohet dirket me notë në përfundim të provimit përfundimtar. Është i paqartë përcaktimi në aktet e brendshme të KUQ se “ <i>Pasi komunikimit te notes për secilin student, studenti i cili nuk është dakord me vlerësimin e dhëne, qëndron ne auditor për t'i bere komisionit prezent ankesën ose për tu pyetur rreth se njëjtës teze diplome.</i> ” pasi procedura e ankesës ndaj vlerësimit duhet të trajtohet në mënyrë të ndryshme sipas gjykimit të GVJ.								
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti pajiset me diplomën përkatëse sipas formatit të miratuar por suplementi i diplomes duhet të jetë specifik për këtë program studimi dhe nuk është një format unik për çdo program studimor.								
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentit i vihet në dispozicion nga sekretaria Diploma, lista e notave dhe suplementi i diplomës i cili nuk është specifik për këtë program studimi. Materialet e tjera i vihen në dispozicion nga sekretaria me kërkesë të vetë studentit.								
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Sipas statutit të KUQ, kjo është detyrë që i ngarkohet Sekretarisë mësimore që është njëkohësisht dhe përgjegjëse per arkivimin e dokumentacionit.								
Shkalla e përbushjes së standarit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.	Referuar Statutit të KUQ, Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënavë lidhur me stafin akademik dhe ruajtjen e tyre në dosjet përkatëse. Nga një kontroll i rastësishëm

Adresa: "Ruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë i një çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	fizik i kryer nga GVJ, të dhënët e personelit efektiv dhe me kontratë rezultonin në përputhje me kërkesat ligjore. Departamenti i së Drejtës Civile dhe të Biznesit mban kopjet e CV të gjithë pedagogëve që jashtë mësim në programin e studimit MP "Jurist me Drejtës Biznesi".								
Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	GVJ vlerëson se Institucioni duhet të jetë më i kujdeshëm në ruajtjen e të dhënavëve në lidhje me rekrutimin e personelit akademik. Sidoqoftë në RVB dhe gjatë vizitës, autoritetet drejtuese konfirmojnë se procedura e rekrutimit realizohet sipas rregullores me propozimin e departamentit të miratuar nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori, të cilët përcaktojnë "Kriteret për vlerësimin e kandidatëve që konkurojnë për një vend të lirë pune me kohë të plotë". Në këtë drejtim këshillohet një transparencë më e plotë. Në Institucion GVJ u njoh me faktin se për vlerësimin e kandidaturave ngrihet një komision nga administratori i KUQ, por në bazë të ligjit duhet të jenë vetëm autoritetet akademike që veprojnë në këtë fushë. Këshillohet në këtë pikë një ndarje më e qartë e procedurave administrative nga ato akademike. Në vizitën në Institucion, GVJ u njoh me procedurën e rekrutimit të stafit akademik, ku kërkesa pasi miratohet nga Dekani dhe Rektori publikohet online në faqen zyrtare të Kolegit Universitar "Qiriazi" (www.qiriazi.edu.al), në median elektronike dhe të shkruar. Mungon sidoqoftë evidencia mbi bazën dokumentare.								
Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritereve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.									
Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulët dhe përbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në takimin me zyrën e burimeve njerëzore dhe verifikimin e CV-ve të stafit akademik, rezulton se Institucioni rekruton dhe angazhon staf akademik cilësor të specializuar në fusha të ndryshme të së drejtës i cili angazhohet, për nevojat institucionale, edhe në fusha me ekspertize të ndryshme brenda profilit të gjerë akademik të drejtësisë.								
Shkalla e përbushjes së standartit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Një përbushje</th> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Një përbushje	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht			X	
Një përbushje	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht						
		X							

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të	Institucioni angazhohet për të garantuar realizimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve ndihmëse që lidhen me programet e studimit që ai ofron. Infrastruktura, mjetet dhe pajisjet në të gjitha mjediset e

personelit në mënyrë profesionale.	godinës, laboratorët në funksion të programeve të studimit është e mjaftueshme dhe në standarte bashkëkohore. Institucioni disponon një bibliotekë, shton vit pas viti fondin e vetë me botime të shkruara dhe dixhitale, dhe e vë atë në shërbim të personelit dhe studentëve. Infrastruktura mbetet nga pikat e forta të Institucionit dhe baza optimale për zhvillimin e mëtejshëm të mjedisit akademik.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjatë vizitës në Institutacion u konstatua se KUQ angazhohet në organizimin e konferencave shkencore kombëtare, seminare, debate shkencore të fushës së jurisprudencës ku janë ftuar edhe personalitete të njoitura akademike. Megjithatë të tilla aktivitete mbeten sporadike në saj të numrit të vogël të studentëve. Formimi shkencor dhe rritja e mëtejshme e stafit pedagogjik mbeten kryesisht iniciativë individuale.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Përgjithësisht detyra për rritjen akademike në lidhje me metodat e mësimdhënies mbetet në kuadrin e detyrimit personal. Institucioni nuk paraqiti evidence në lidhje me organizimin e programeve specifike për metodat e mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Për shkak të numrit të vogël të studentëve të regjistruar në ketë program studimi (4 student) angazhohet një numër i reduktuar personeli akademik, fakt për të cilin mund të krijohet mbingarkesë akademike. Edhe zyrat ndihmëse kanë personel të reduktuar ku në një zyrë mund të ndodhet vetëm një person ose një person që mbulon më shumë zyra (sekretaria mësimore, zyra e burimeve njerëzore, këshillimi i studentëve, etj)
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbusjet Përbushjet pjesërisht Përbushjet kryesisht Përbushjet plotësisht X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në Institutacion rezulton se KUQ disponon ambjente të përshtatshme mësimore që garantojnë veprimtarinë normale akademike. Numri i vogël i studentëve lejon një përdorim të bollshëm të ambjenteve duke garantuar përmasat ligjore sa i përket hapësirave. Auditoret paraqiten në standard dhe në përputhje me nevojat akademike të studentëve. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratori, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të	Institucioni ofron mjete të teknologjisë së informacionit si projektorë dhe kompjutera.

metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënie.	
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përbajnjë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërsi.	Proceset e mësimdhënies mbeten kryesisht të natyrës teorike, arsyё për të cilën nuk ka përdorim laboratorësh. Është krijuar sidoqoftë laboratori i klinikës ligjore ku kryhet edhe praktika mësimore. Ky laborator ofron mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërsi. Dy laboratorë informatike janë në ndihmë të gjithë veprimtarisë akademike.
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ ka konstatuar se KUQ disponon një laborator me standarte bashkëkohore për zhvillimin gjuhëve të huaja.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zoteron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Sipas RVB dhe rregullores se programit të studimit MP "Jursit me Drejtim Biznesi", ne planin mesimor është përcaktuar zhvillimi i praktikës mësimore, por dhe i zhvillimit të diplomës. Nga dokumentacioni shtesë kërkuar nga GVJ gjatë vizitës, rezulton se Institucioni ka nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi në funksion të praktikës mësimore.
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënie, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënie dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënie për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka në dispozicion bibliotekën që përdoret vazhdimisht nga ana e pedagogëve e studentëve. Institucioni ka në dispozicion salla për aktivitetin studimor, Bibliotekën, Sallën e Leximit respektivisht me sipërfaqe prej 54.625 m ² , 49.29 m ² dhe 141.3924 m ² . Biblioteka ka në dispozicion tekste shqiptare dhe të huaja. Në fondin e saj gjenden tekstet e detyrueshme e programit të studimit. KUQ ka një politikë përkthimin dhe botimin e teksteve universitare, por nuk rezultojnë tekste të përkthyera nga Institucioni deri në këtë moment.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme përmblimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Aksesi në biblioteka on-line, i garanton aksesin studentëve dhe stafit akademik, në platforma të njohura të cilat mund të jenë të
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së	

programit të studimit.	dobishme për të gjithë të interesuarit anëtarë të KUQ.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Institucioni ka në dispozicion pajisje elektronike kompjuterike që lejojnë aksesin në dokumentacionin on-line të bibliotekës për të facilituar punën e studentëve, të cilët u shprehën pozitivisht për këtë mundësi gjatë takimit me GVJ.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni investohet seriozisht në pasurimin e fondit të bibliotekës siç është parashikuar edhe në aktet rregullative të tij. Procedurat për pasurimin e teksteve formalizohen në bazë të kërkesave që vijnë nga njësitet bazë. Kjo është evidentuar nëpërmjet dokumentacionit shtesë të kërkuar nga GVJ.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtëj tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik nga e hëna në të premte 8.00 – 16.00. Përmasat e vogla të Institucionit justifikojnë kufizimin në orarin e mbasdit të vizita u konsatua se stafi dhe studentët shprehin opiniione pozitive në lidhje me përdorimin e saj.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financier e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Këshillimi i studentëve realizohet nga sekretaria mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e statistikave. Statistikat vjetore analizojnë numrin e të diplomuarve për të gjitha programet që ofrohen. Pas verifikimit realizuar nga GVJ, rezulton se KUQ disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, MP "Jurist me Drejtim Biznesi", transferimet dhe mos përfundimin me sukses të vitit akademik. Konkretnisht rezultojne 3 studentë të regjistruar për here të pare dhe 1 student i transferuar. KUQ disponon të dhëna për ecurinë akademike në lidhje me notën mesatare në hyrje dhe në përfundim të ciklit studimit, ecurinë gjatë vitit akademik, procesin e diplomimit etj. Vetëm një person rezulton përgjegjës për të dyja zyrat në saj të numrit të vogël të studentëve.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u njoh me dosjet e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Menaxhimi elektronik i të dhënavëve nuk aplikohet, por përcillet vetëm fizikisht. Rezulton se strukturat akademike dhe administrative informojnë në mënyrë permanente personelin dhe studentët e programit të studimit MP "Jursit me Drejtim Biznesi" mbi rregulloret, udhëzimet, aktivitetet mësimore, kërkimore shkencore dhe të çdo lloj forme tjetër që lidhet me këtë program.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të	

gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.									
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.									
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundeson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.									
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Faqja e internetit www.qiriazi.edu.al përcjell kryesisht informacionin që lidhet me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, të cilat janë te publikuara në faqen e internetit në gjuhën shqipe dhe atë angleze.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport finanziar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në statutin e KUQ, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, administratori harton çdo vit, projekt buxhetin vjetor dhe propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit (Neni 10). Ky buxhet siguron financimin e shpenzimeve për realizimin e programit.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative përmirësuese, teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet përbibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfitura dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Sipas informacionit të siguruar në institucion dhe dokumentacionit shtesë të kërkuar nga GVJ, institucioni realizon çdo vit audit të jashtëm, nëpërmjet të cilit miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Sipas RVB drejtimet e shpenzimeve fokusohen në rritjen e cilësisë së programeve dhe studimeve, përmirësimin e stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës që lidhet me kushtet e punës dhe mesimdhëni, si hapësirat e Institucionit, kushtet higjeno-sanitare, të ruajtjes fizike, përdorimit të drithës, kushtet e mësimdhënieve dhe qëndrimit, sistemeve teknologjikë përvillimit e aktiviteve mësimore dhe shkencore.

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përban një pasqyrë të hollësishme financiare të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Në RVB afirmohet se Institucioni auditohet çdo vit nga një kompani e certifikuar, ku miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Mbi këtë pikë mungon evidencia.								
Kriteri 4. Në myllje të çdo cikli të plotë studimi, institucion dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Bordi i Administrimit analizon në mënyrë periodike të dhënat financiare të Institucionit, në mënyrë që të përllogarisë sasinë dhe sektorët e ndërhyrjes duke qenë se të ardhurat e pakta nga studentët nuk lejojnë një vetëfinancim të plotë. Bordi tregon vëmendje të veçantë ndaj përmirësimeve infrastrukturore të rëndësishme që lidhen me kushtet e punës dhe mësimdhënien, si hapësirat dhe një mjedis të plotësuar në kushtet e temperaturës, higjeno-sanitare, të ruajtjes fizike, dritës, kushteve sa më të mira të mësimdhënies dhe qëndrimit, operimin me sisteme moderne të zhvillimit të aktiviteteve mësimore dhe shkencore. Gjatë vizitës në Institucion u vu re nevoja e ndërhyrjeve të mëtejshme në përmirësimin e kushteve të punës, me modernizimin pajisjeve për klimatizimin dhe higjeno sanitare.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen									
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	Vlerësimi i ekspertëve
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Kolegji Universitar "Qiriazi" nëpërmjet parashikimeve në rregulloret e saja, që nga Rregullorja e KUQ, Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë deri te Rregullorja e programit të studimit, përcaktion kritere dhe një politikë për të rregulluar jetën akademike të studentit në Institucion. Kështu rregullohet pranimi, transferimi, vijimi i
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat	

nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjtë për të gjithë kandidatët për studentët dhe studentët e programit të studimit.	studimeve, humbja e statusit të studimeve, diplomimi, etj. KUQ përcakton kriteret minimale ligjore ashtu sikur në legjislacionin përkatës për këtë temë dhe nuk ka vendosur kritere shtesë pranimi apo procedura konkurente të tjera (duke qenë se aplikimet nga kandidatët janë poshtë kuotave të përcaktuara për programin e studimit). Kriteret janë kritere minimale ligjore dhe i takon kryesisht Sekretarisë Mësimore apo Zyrës së Këshillimit të Karrierës, Pranimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë për të bërë të njohur kto kritere dhe për ti publikuar. Këto zyra nga vizita në institucion rezultojnë nën kapacitetet e nevojshme të burimeve njerëzore për të luajtur një rol aktiv dhe për të menaxhuar të gjitha këto detyra.			
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtaçisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.				
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përparrë çdo viti akademik kritere të veçanta për përgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Institucioni nuk parashikon kritere shtesë pranimi për studentët që kërkojnë të regjistrohen përtëj kritereve ligjore dhe kriteret e pranimit shapllen në web-in e KUQ në kohë të përshtatshme për regjistrimin e mëvonshëm. I takon zyrës së këshillimit të karrierës për të bërë informimin e studentëve që janë në ndjekje të ciklit të parë bachelor.			
Kriteri 5. Përparrë fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkasat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjeterin.	Nga takimi me stafin akademik GVJ u njoh se kryesisht ky informacion ofrohet nga pedagogët e njësise bazë gjatë javës së parë të fillimit të leksioneve.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni e ofron këtë informacion së pari nëpërmjet takimeve me studentët potencialë, nëpërmjet zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe përgjatë përiudhës së marketingut nëpërmjet web-it. Kryesisht informacionet që lidhen me përparimin në karrierën akademike dhe vlerësimin e studentit jepen nga ana e antarëve të departamentit përgjatë orëve të leksionit në javën e pare. Gjithashtu studentët kanë në dispozicon dhe syllabuset e lëndëve përkatëse dhe planin mësimor.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Përsa i përket punimit përfundimtar nga ana e KUQ janë marrë masat për të bërë të njohur udhëzuesin për kryerjen e punimit përfundimtar por edhe fondin e pyetjeve (megjithëse GVJ është e mendimit se çdo student i këtij cikli duhet ta përbyllë ciklin e studimeve me punim
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	

<p>Kriteri 5. Përparrë fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>diplome).</p> <p>Takimet informuese në fillim të vitit organizohen nga ana e njësisë bazë që menaxhon programin e studimit dhe përgjegjësi i departamentit. Rekomandohet përfshirja direkte e më aktive e Zyrës së Këshillimit të Karrierës për këtë qëllim.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" data-bbox="599 467 1429 563"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th><th>Përbushet pjessërisht</th><th>Përbushet kryesisht</th><th>Përbushet plotësisht</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td></td><td style="text-align: center;">X</td></tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjessërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjessërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitet e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Informacionin e nevojshëm në lidhje me mënyrën e zhvillimit të programit të studimit dhe parashikimet për të gjithë ciklin një vjecar të studimit studentët e kanë të plotë. Gjithashtu përfshirja e tyre brenda institucionit realizohet nëpërmjet kontaktit me Njësinë Bazë, me sekretarinë mësimore dhe në faqen web të KUQ.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Njësia bazë në bashkëpunim me sekreterinë mësimore e cila vendos në dispozicion të studentit të gjithë dokumentacionin në lidhje me procesin mësimor, menaxhojnë programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitet e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nëpërmjet njësisë bazë, lektorëve të përfshirë në mësimdhënie dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës, studentët marrin informacionin për ofertat që vijnë nga tregu i punës dhe orientohen në lidhje me vijimësinë e tyre. Megjithatë Zyra e Këshillimit të Karrierës (nga vizita në institucion) duhet të ketë një plan punë në lidhje me aktivitetet institucionale që zhvillohen me këtë qëllim. Këshillimi duhet të kryhet sipas një formati të përcaktuar qartë për studentin dhe nuk mund të mbetet vetëm në raporte dhe kontakte direkte me studentin. Gjithashtu duhet një programim vjetor i panaireve, kontakte me punëdhënës të ndryshëm dhe evenete të organizuara për takimin student-operatorë në tregun e punës me qëllim rritjen e angazhimit insitucional në këtë proces.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjërë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni nga ana e zyrave administrative për sa i përket zhvillimit të procesit mësimor është i mjaftueshëm dhe kryesisht operohet nëpërmjet emailit për studentët në distancë dhe nëpërmjet platformës online E-learning.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësishët i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua se operohet edhe me anë të kontaktit direkt telefonik duke u nisur nga numri i kufizuar i studentëve.</p> <p>Dokumentacioni administrohet nga Sekretaria mësimore dhe nga</p>

	vizita në institucion u vërejt se në aspektin e kapaciteteve sekretaria ka mungesë të burimeve njerëzore.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Gjendet statistika në lidhje me nr e studentëve në programin e studimit (Aneks II-8 Numri i studentëve në FD) të përpiluara nga sekretaria mësimore. Aktualisht në këtë program studimi ndjekin studimet 4 studentë.			
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Megjithatë kjo statistikë që del nga ky dokument duhej të hartohej më vetë për çdo program studimi në mënyrë analitike. Pra institucioni duhet të mbajë më vetë pranë departamentit përkatës informacionin e qartë për largimet nga programi specifik apo përvijueshmërinë e studentëve.			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Bazuar në RVB dhe gjatë vizitës në Institutacion u konstatua se informacioni në lidhje me ecurinë e studentëve është në dispozicion pranë Sekretarisë Mësimore por mungon një dokument analize përkatëse me arsyet e largimit, motivet e transferimit, etj. Nga vizita doli se të dhënat janë të ruajtuara në institucion dhe janë të aksesueshme kundrejt kërkesës.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të janë të sigura dhe lehtësish të verifikuashme nga personat e autorizuar.				
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Në sekretarinë mësimore apo departament nuk disponohet një raport analistik në lidhje me gjendjen e studentëve në hyrje apo në dalje të programit të studimit. Gjithashtu Zyra e Karrierës (duke qenë se ka patur edhe zëvëndësim stafi dhe punonjësi aktual është i ri në detyrë) nuk ka një plan të qartë në lidhje me gjurmueshmërinë e studentëve në tregun e punës.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni në aktet e tij të brendshme parashikon përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe në organe si NJSBC apo Këshilli i Etikës. Gjithashtu institucioni është në hapat e para të ngritjes dhe përkrah ngritjen dhe angazhimin e studentëve në shoqatat studentore. Nr. i vogël i studentëve nuk lejon të kuptojmë qartë menaxhimin e proceseve zgjedhore brenda në KUQ dhe platformat efektive të kandidatëve të ndryshëm që shprehin dëshirën për tu zgjedhur. Kontaktet me studentët mbahen direkt nga strukturat drejtuese të njësive por duhet të luajë një rol më të madh Zyra e Këshillimit të Karrierës me qëllim ngritjen e vetëdijes studentore dhe bërjen sa më të qartë të të drejtave të tyre. Gjithsesi NJSBC duhet të angazhohet që leximi i pyetsorëve të studentëve të zbardhet dhe të përpilohet një akt që të jetë më lehtë i aksesueshëm nga vetë studentët dhe jo vetëm të trajtohet në mbledhje të organeve kolegjiale (duhet një raport statistikor i leximit të pyetsorit).								
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.									
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	KUQ parashikon dhe ka kryer herë pas here ndryshime në programin e studimit duke u nisur nga mbledhjet në department dhe ka komisionet përkatëse për njohjen e lëndëve sipas ngarkesës nga studentë që mund të vijnë nga programe studimi të tjera të transferuara apo që u njihen lëndë të caktuara të shlyera. Gjithsesi nga vizita në institucion nuk u pa një model faktik i transferimit të studimeve edhe duke u nisur nga nr i vogel i studentëve. Nga sa doli nga vizita në insitucion studentët u përgjigjën se mendimi i tyre merret në lidhje me proceset e rishikimit të programit të studimit dhe se këtë e diskutojnë me pedagogët. Gjithsesi një përpjekje për ta kanalizuar këtë në nivel institucional duhet të kryhet ku zëri i studentëve të jetë më i artikuluar në përfaqësitetë e tyre në organet kolegjiale (të shihet mundësia e krijimit të klubeve studentore apo shoqatave). Në këtë drejtim duhet të rishihet edhe formati i pyetësorit për studentët që të jetë më i detajuar me qëllim përbushjen e kësaj pike.								
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	E drejta për ankimim e studentëve është e përcaktuar në Rregulloret e KUQ megjithëse ekziston një paqartësi midis Rregullores së KUQ neni 65 dhe Rregullores së FD neni 67 e Rregullores së DDCB neni 35 për mënyrën e trajtimit të ankesave të studentëve nësë është përgjegjës Drejtuesi i Departamenti apo Dekani. Gjithsesi regjistri i ankesave i mbajtur pranë Dekanatit është një risi në këtë drejtim.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X		
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
	X								

Standardi V.6

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësish të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	KUQ ka ngritur një njësi që është Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, e Pranièmeve dhe e Këshillimit për Karrierë e cila duhet të përbushë detyrimet e përcaktuara ligjore në lidhje me informimin e vazhdueshëm të studentëve gjatë karrierës së tyre akademike dhe më vonë. Në rradhë të parë jemi të gjykimit se kjo zyrë është nën kapacitetet e nevojshme të burimeve njerëzore. Së dyti, kjo zyrë ka disa detyra funksionale duke përfshirë edhe marrëdhëniet me jashtë që e bën të pamundur që kjo zyrë të kryejë me eficencë detyrat në kuadër të këshillimit të karrierës. Aktualisht numri i ulët i studentëve në Institucion dhe në porgramin e studimit të posaçëm në vlerësim e lehtëson punën e zyrës në gjurmimin e studentëve. Gjithsesi ka mungesa nga ana e Zyrës në kryerjen e detyrave të sajë funksionale siç janë panairet e punës, takime student -biznes, organizimi eveneve specifike me të ftuar për këshillim karriere, etj duke u nisur nga detyrat e shumta të ngarkuara dhe pësoneli i pamjaftueshëm. Nga vizita në institucion mungon thelbësish dokumentacioni programatik vjetor në formën e planit të punës.								
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.									
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucion e tjerë dhe orientimin në tregun e punës.									
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoritatetëve drejtuese përkatëse									
Shkalla e përbushjes së standartit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X		
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
	X								

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X		

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni I arsimit te larte ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Procedura dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), është strukturë ndihmëse në funksion të zbatimit të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe varet nga Rektori i KUQ, sipas përcaktimve në statutin e KUQ (Kreu VIII, Neni 43, fq. 23), rregulloren e tij (Kreu XIII, Neni 89 pikat a, b, c, d, e dhe f) dhe rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë, Departamentit të së Drejtës Civile dhe Biznesit dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo strukturë ka në objektivat e punës zbatimin e metodave të vlerësimit dhe të vetëvlerësimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së institucionit. Pjesa qendrore e vlerësimit të performanës akademike e profesionale bazohet në formularë tip të depozituar në dokumentacionin e vlerësimit. Manuali i Cilësisë tregon angazhim nga ana e Institucionit në këtë drejtim. NJSBC monitoron në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e veprimitarise mësimore dhe kërkimore-shkencore për të gjitha programet. Këto veprimitari përbledhin format e kontrollit periodik të stafit akademik si dhe të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e tyre.								
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Objektivat e punës së kësaj njësie lidhen me zbatimin e metodave të vlerësimit dhe të vetëvlerësimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së institucionit. Pjesa qendrore e vlerësimit të performanës akademike e profesionale bazohet në formularë tip të depozituar në dokumentacionin e vlerësimit. Metodat e vlerësimit janë ato tipike të llojit sasior dhe cilësor në vlerësimin e ecurisë së programit studimor MP "Jurist me Drejtim Biznesi", sasior lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënavë nga pedagogët dhe studentët dhe cilësor pasi analizon proceset e mësimdhënies/mësim-nxënies, analizon praktikat e ndjekura në vlerësim, përmirëson komunikimin student-pedagog, etj. Të dhënat i vihen në dispozicion autoriteteteve drejtuese dhe janë objekt analize në nivele departamenti. Nga vizita në institucion, komunikimi me anëtaret e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe takimet me pedagogët e studentët, numri i vogël i studentëve lejon edhe një kontroll të drejtpërdrejtë nëpërmjet takimit me studentët.								
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të quartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit									
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënëtit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngrë njësi	Njësia përgjegjëse për shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të

të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	studimit të ciklit të dytë është departamenti. GVJ e ka konfirmuar këtë edhe gjatë vizitës në Institucion. Procedura parashikon miratimin në Senat (neni 14, Statuti KUQ).								
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Nuk rezulton të jenë filluar procedura të rishikimit të programit të studimit Master Profesional nga ana e Institucionit, duke qenë se koha e rifillimit të aktivitetit akademik është 3-vjeçare.								
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për mbarëvajtjen e programeve të studimive.	Institucioni tregon vëmendje të veçantë drejt organizimit dhe menaxhimit; financimit të përshtatshëm; politikave të qëndrueshme për rekrutimin e stafit; procesit të rregullt mësimor; incentivimit të mobilitetit të pedagogëve dhe studentëve; zbatimit të ECTS, zhvillimit të kurrikulës, metoda të reja të mësimnxënies dhe tutorimit, procesit të kërkimit shkencor etj. Aktivitetet e sipërpërmendura mbeten të kufizuara në saj të kohës së shkurtër të veprimitarisë dhe numrit të vogël të studentëve duke qenë se rezultojnë të regjistruar 4 studentë në vitin akademik aktual.								
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Gjetjet e NJSBC institucioni i zhvillon në formën e diskutimeve në nivel Senati, Fakulteti dhe Departamenti. Në këto nivele diskutohet me tej për dobesitë e konstatuara dhe për ecurinë e programeve, si edhe për përmirësimin e tyre. Në bazë të rezultateve të këtij procesi mund të adoptohen edhe vendimmarrje në lidhje me ndryshime apo zhvillime të rëndësishme në fushën akademike e shkencore që synojnë përmirësimin e programit MP "Jurist me Drejtim Biznesi".								
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.									
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Gjatë vizitës në institucion GVJ është njohur me faktin se NJSBC përpilon një raport vlerësimi të brendshëm për programin e studimit çdo vit. Gjetjet dhe rezultatet pasi diskutohen në Departament, reflektohen edhe në raportin vjetor institucional.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme	Metodologja e vlerësimit, instrumentat matëse dhe vlerësuese janë të shpjeguara në Raportin e Vetëvlerësimit që bën Njësia për arritjen e

<p>e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>sigurimit të brendshëm të cilësisë, dhe gjithashtu objekt i shqyrtimit dhe adresimit të detyrave përkatëse nga ana e autoriteteve drejtuese brenda Institucionit.</p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda kryesish direkte, po ashtu sasiore dhe cilësore. Pjesë e vlerësimit janë edhe intervistat me studentët dhe dëgjimi në auditor. Metodologjia direkte përbën instrumentin kryesor në saj të numrit të vogël të studentëve dhe kohës së shkurtër të ekzistencës së programit.</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfshira nga ky program</p>									
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesht	Përbushet plotësisht		X		
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesht	Përbushet plotësisht						
	X								

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka strukturuar aktet e brendshme rregullative në përputhje me Kodin e Cilësisë të ASCAL dhe Manualin e brendshëm të Cilësisë. Në KUQ përgjegjës për cilësinë janë të gjitha strukturat drejtuese, posaçërisht departamenti, fakulteti dhe rektorati. Institucioni nuk cakton ekspertë të jashtëm për verifikimin e gjendjes së punës. Analiza e një eksperti të jashtëm do të mundësonte rekomandime të mëtejshme për metodologjinë e mësimdhënies, të kontrollit të njohurive, përmirësimin e tyre, përshtatjen e metodave të reja në gërshetim me teknikat/metodat tradicionale, dhe çdo komponent tjetër në funksion të rritjes së</p>

	cilësisë dhe shkëmbim të praktikave të mira.								
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në përputhje me manualin e cilësisë parashikohet angazhimi i gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë, veçanërisht në: <ul style="list-style-type: none"> ◦ sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë akademike; ◦ hartimin e programeve cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë; ◦ përcaktimin e parimeve, standardeve dhe proceduarave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. Gjatë takimit me NJSBC u konstatua se Përgjegjësja e Departamentit “E Drejtë Civile dhe Biznesi” është pjesë e struktura së NJSBC. Kjo justifikohet me përmasat e vogla të Institucionit.								
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni ka parashikuar me korrektsi në rregulloren e NJSBC-së standartet e nevojshme për të evitar çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.								
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shhangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni nuk ka parashikuar përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo si rrjedhojë e kohës së shkurtër së veprimtarisë të Institucionit.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushjet</th> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushjet	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht			X	
Nuk përbushjet	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht						
		X							

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të janë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë kriujimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni ka politika të veçanta të transparencës të rezultateve që shprehen veçanërisht në dokumentin “Politikat e Vlerësimit të Brendshëm”. Gjatë vizitës në KUQ u afirmua se një nga format më të përdorura mbi cilësinë është Pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si edhe palëve të interesuara.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legislacionin për të dhënat personale.	KUQ disponon një web-site (https://www.qiriazi.edu.al/) ku nuk rezulton të ketë publikime lidhur me rezultatet dhe gjetjet e NJSBC-së.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që	Sic u afirmua më lart, Përgjegjësja e Departamanit është pjesë e

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-48428

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	strukturës së NJSBC, si pasojë masat reflektohen në Njësinë përkatëse drejtuese. Fakulteti vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive që bëhen në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë nga NJSBC si dhe nga raportet e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit.								
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka staf të reduktuar në aspektin e monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Nuk rezultojnë të zhvillohen veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X		
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
	X								

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X		

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional
“Jurist me Drejtim Biznesi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar
Qiriazi”

Pikat e forta dhe afirmime


1. KUQ ka vizion në perspektivën e zhvillimit të Institucionit në përputhje me kërkesat e tregut për të cilat ofrohet programi MP “Jurist me drejtim Biznesi”. Drejtimet e përcaktuara në aktet irregullative të institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të programit janë të orientuara saktë e me perspektivë të qartë, duke i shërbyer efektivisht punës akademike.
2. Infrastruktura e institucionit është cilësore e funksionale dhe ndihmon në përbushjen efikase të programeve dhe veprimitarisë së tij.
3. Literatura që ofrohet në bibliotekën e institucionit ndihmon studentët dhe stafin akademik në realizimin e programit të studimit.
4. KUQ ka një axhendë ambicioze për bashkëpunimin me aktorë të tjera privatë dhe institucionalë e cila ndihmon programin e studimit të ketë sukses.

Pika të dobta

1. Personeli Akademik Efektiv nuk mbulon në masën 70% ngarkesën mësimore, referuar planit mësimor të dorëzuar nga Institucioni.
2. Rregulloret e FD, Departamentit dhe e Programit të Studimit kanë mospërputhje në lidhje me procedurat e ankimimit dhe vlerësimit të studentëve.
3. I njëjtë person mbulon shumë funksione, si në rastin e Përgjegjësit të Departamentit që mbulon disa funksione në këtë Institucion.
4. Stafi administrativ-ndihmës është nën kapacitet, sepse është vënë re që në disa raste i njëjtë person mbulon zyra të ndryshme administrative.
5. NJSBC, në disa nga detyrat e saj ka një rol formal, jo inçiziv në kuadrin e aktiviteteve akademike.
6. Institucioni nuk ka përdorur ekspertizë jashtë Institucionit për vlerësimin e programeve të studimit dhe cilësinë akademike, duke kufizuar një burim të mundshëm për rritjen e mëtejshme institucionale.

Rekomandime

1. Rekomandohet rekrutimi i stafit të brendshëm akademik me qëllim mbulimin e mbulimin e ngarkesës së programit të studimit në 70% sipas përcaktimeve ligjore.



2. Ngritja e një grupei pune më qëllim rishikimin e Rregulloreve të funksionimit dhe pwrditwsimi i saj.
3. Rekomandohet të shtohet stafi administrativ me funksionin ndihmës të procesit mësimor si edhe të lehtësohet puna e Përgjegjësit të Departamentit i cili është i angazhuar po ashtu në funksione të tjera si koordinator i programit apo anëtar i NJSBC.
4. Rekomandohet rritja e transparencës në aktitivetet që lidhen me NJSBC.
5. Në kuadrin e standardizimit me praktikat e mira të punës, rekomandohet të përdoret ekspertiza e jashtme e profesionistëve më të mirë në fushën akademike, për vlerësimin e programeve të studimit dhe cilësinë akademike.

Conclusions of the Evaluation of the Second Cycle Study Program Professional Master in "Business Lawyer" of the Institute of Higher Education University College "Qiriazi"

Strengths and affirmations:

1. University College Qiriazi has a vision in the development perspective of the Institution in accordance with the market requirements for which the Professional Master program "Business Lawyer" is offered. The orientations set out in the institution's regulatory acts and program development strategy are precisely oriented having a clear perspective, serving effectively to the academic work.
2. The infrastructure of the institution is qualitative and functional and helps in the efficient fulfillment of its programs and activities.
3. The literature provided in the institution's library assists students and academic staff in the realization of the study program.
4. UCQ has an ambitious agenda for collaborating with other private and institutional actors that helps in the success of the study program.

Weaknesses:

1. Effective Academic Staff does not cover 70% of the teaching load according to the curriculum submitted by the Institution.
2. The regulations of the Law Faculty, Department and Study Program have discrepancies regarding grievance procedures.
3. Many functions are performed by a single person as in the case of the Head of Department who covers several functions in this Institution.

4. Administrative-assistant staff is below capacity because it has been observed that in some cases the same person covers different administrative offices.
5. The Internal Quality Unit (IQU), in some of its tasks has formal, non-inclusive role in the context of academic activities.
6. The Institution has not used outside-Institution expertise to evaluate study programs and academic quality, limiting one potential source for further Institutional growth.

Recommendations:

1. Recruitment of effective academic staff is recommended in order to cover the program with enough lecturers as required by law.
2. Establish a working group to review the Rules of Procedure.
3. It is recommended to increase the administrative staff with the auxiliary function of the teaching process as well as to facilitate the work of the Head of Department who is also engaged in other functions as a program coordinator or member of the IQU.
4. It is recommended to increase transparency in activities related to the IQU.
5. In the context of standardization with good work practices, it is recommended to use the external expertise of the best professionals in the academic field for the evaluation of study programs and academic quality.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërish	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE		X		
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE VLERËSIMI TËRËSOR		X		

